

URDHËR
Nr. 126, datë 9.2.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 21, DATË 19.1.2023,
“PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN FUNDOR
TË QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17
DHE 18)”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të marrëveshjes “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

Në urdhrin e ministrit nr. 21, datë 19.1.2023, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 3 riformulohet, si më poshtë:

“3. Të gjitha anijet e peshkimit fundor, që peshkojnë peshq fundorë, nuk kalojnë 20 231 ditë peshkimi në vitin 2026, të ndara sipas segmentit të flotës, në përputhje me pikën 4 të këtij urdhri”.

2. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Ditët e peshkimit ndahen sipas segmenteve të flotës për anijet e peshkimit fundor që përdorin rrjetë fundore me timon (OTB)”, si më poshtë:

a) segmenti ≥ 12 m dhe < 24 m: 14 913 ditë;

b) segmenti ≥ 24 m: 5 318 ditë.”.

3. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me përmbajtje si më poshtë:

“9/1. Me qëllim përmirësimit gradual të gjendjes së stokut të skampit në Detin Adriatik (*Nephrops norvegicus*), ndalohet peshkimi fundor në periudhën 15 shtator–31 dhjetor në zonën përcaktuar në shtojcën 1 të këtij urdhri, me koordinata si vijon:

a) 42.172625 N 18.428678 E;

b) 41.945840 N 18.234324 E;

c) 41.516110 N 18.566044 E;

d) 41.608434 N 18.702653 E.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

Shtojca 1

**Zona me regjim të kufizuar peshkimi fundor (ndalim peshkimi fundor në periudhën
15 shtator–31 dhjetor të çdo viti)**

